



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

AKADEMIA EVOLUCION
RAPORT I MONITORIMIT

11.05.2023, Prishtinë

1. HYRJE

Zyrtarët përgjegjës të AKA-së për procedurën e monitorimit:

- *Naim Gashi, Drejtor i AKA-së,*
- *Leona Kovaçi, ZL për Monitorim dhe Vlerësim;*
- *Mirlinda Xhylani, Praktikante.*

Data e fillimit të procedurës së monitorimit: 11.05.2023

Monitorimi është realizuar:

- a) në distancë
- b) me vizitë në terren me paralajmërim
- c) me vizitë në terren pa paralajmërim

Data e vizitës monitoruese (nëse aplikohet): 11.05.2022

Personat me të cilët zyrtarët e AKA-së janë takuar në vizitën në terren (nëse aplikohet):

- *Flora Loshi, Profesoreshë;*
- *Dritan Shatri, Zyrtar për Financa.*

Burimet e informimit për raportin e monitorimit:

- *Web faqja e Akademisë Evolucion;*
- *Panoja e publikuar për student;*
- *Intervista me Profesor dhe Asistentë.*

2. Përshkrim i shkurtë i zhvillimit të procedurës së monitorimit për verifikimin e orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve, përfshirë të dhënat në rend kronologjik (nëse aplikohen):

Vizita monitoruese filloi në orën 13:00, në Akademinë Evolucion në Prishtinë.

Ekipi i monitorimit ka vizituar Akademinë Evolucion dhe me arritje në institucion ka qenë i pranishëm vetëm Zyrtari i Financave i cili e ka njoftuar ekipin e AKA-s se mësimdhënësit, momentalisht janë në pauzë. Në panelin njoftues për studentë të institucionit, të gjitha informata mbi orarin mësimorë kanë qenë të publikuara.

Ekipi i monitorues ka hasur në disa studentë dhe ka bashkëbiseduar rreth orarit dhe ligjëratave, në diskutim e sipër janë konfirmuar se ata kanë qenë pjese e ligjëratave në orarin e paradites sipas planifikimit.

Me arritjen e mësimdhënësve, prof. Flora Loshi ka shoqëruar ekipin e monitorues dhe e ka njoftuar me mbarëvajtjen e procesit mësimor në Akademinë Evolucion, ku ka paraqitur informatat lidhur me mësim mbajtjen dhe ka njoftuar ekipin monitorues se procesi mësimor mbahet 15 javë dhe java e 16 është java e përcaktuar për mbajtjen e provimeve.

Gjatë diskutimit, si dëshmi janë paraqitur listat për orë të mbajtura të cilat sipas procedurave të akademisë aprovohen në fund të orarit të punës. Këto lista dorëzohen në administratë për të proceduar më tutje për pagesë të mësimdhënësve.

Në vazhdim e sipër, me përfaqësuesit e akademisë u diskutua edhe procesi i zëvendësimit dhe anulimit të orëve i cili është i rregulluar në formën që çdo orë e humbur zëvendësohet gjatë dhe në fund të semestrit. Organizimi i mësimit është i rregullt dhe jo me korrespondence.

Ekipi monitorues ka qenë prezent në njërin nga klasat ku është zhvilluar puna praktike e studentëve, me prof. Z. Ylber Rukiqi, në skicim, patron dhe qepje, me ç'rast është vërejtur angazhimi i të gjithë studenteve në punë praktike.

3. VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR

1. Ekipi monitorues ka evidentuar se nuk është përditësuar ueb faqja e akademisë me orar të semestrit verorë.
2. Ekipi monitorues ka konstatuar se mbarëvajtja e ligjëratave dhe punës praktike ka qenë në përputhje me oraret e paraqitura si dëshmi.

4. SHTOJCAT (dokumentet e mbledhura gjatë vizitës)

1. Lista e nënshkrimeve të mësimdhënësve;
2. Web faqja e Akademisë Evolucion

Drejtori i AKA-s dhe Zyrtarët për Vlerësim dhe Monitorim të AKA-së

Kryesues

NAIM GASHI 
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)

Anëtar

Liana Kereci 
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)

Anëtar

Mirindë Gashi - Xhytomi 
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)